



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
30.01.2025**

Me datë 30.01.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqeja, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Artan Haxhi, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Gjenarin Kapcari, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Ervin Brahimi, Marina Duhani, Erkan Hoxha, Vjoleta Përndrecaj, Gloria Shllaku, Gjovalin Ndoj, Erkam Hoxha, Samed Bushati, Fatmir Vojvoda, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amila Lici, Plarent Anamali, Jetmira Rraboshta.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2024".*
2. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike".*
3. *Pr/ Vendim: Për një shtesë në VKB nr.76 datë 19.12.2024 „Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës.“ Dhe detajim të fondeve sipas aktit normativ nr.5 datë 19.12.2024 të Ministrisë së Financave”.*
4. *Pr/ Vendim: "Për miratimin në parim të vlerës së bashkëfinancimit dhe listës së përfituesve për realizimin e projektit "Përmirësim i Infrastrukturës, kryesisht në zonat informale" (Rikonstruksion Rruga Roza Lejn dhe Degëzime) ”.*
5. *Pr/ Vendim: "Për miratimin në parim të bashkëfinancimit në zbatim të fondeve të planifikuara për programet e strehimit social për vitin 2025, për realizimin e një kati shtesë në objektin: Banesa sociale me Qira (Ish-Konvikti i Shkollës Veterinare), i përshtatur për strehim social”.*

6. *Pr/ Vendim: "Për një ndryshim në emërtimin dhe ndryshimin e fushës së përdorimit të pjesshëm në VKB nr.51, datë 14.04.2009 "Për miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër", miratuar me VKM nr.421, datë 02.06.2010, të ndryshuar, sipas lidhjes 1, të pronës me numër rendor 13, sipas formularit për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore".*
7. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2025".*
8. *Pr/ Vendim: Për një ndryshim në VKB nr.27 datë: 01.06.2016 „Për ngritjen e Këshillit artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.*
9. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e planit vendor të mbrojtjes së Biodiversitetit".*
10. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Heqje nga Rendi i ditës: (Pika 8)

Pr/ Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.27 datë: 01.06.2016 „Për ngritjen e Këshillit artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë Shkodër”, të ndryshuar

Shtesë Rend dite:

1. *Pr/ Vendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"*
2. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi, të pronave Ish - Reparti Usharak Bërdicë, Pasuria nr 10/127 dhe pasurinë në përgjegjësi të DPSHTRR nga prona shtetërore tek Bashkia Shkodër"*

Kourumi i domosdoshëm është present në salla, mbledhja deklarohet e hapur.

Z.Bjanku merr fjalën dhe ngre shqetësimin e tij dhe të grupit politik të kualicionit të BF për fillimin me vonesë të mbledhjes. Ai shton gjithashtu se rrugës për në mbledhje ai katakuar një qytetar, të cilit nuk i është lejuar të marr pjesë në mbledhjen e Këshillit. Duke cituar rregulloren e Këshillit ai thotë se kemi të bëjmë me shkelje flagrante të ligjit, pasi mbledhjet duhet të jenë të hapura dhe të aksesueshme për qytetarët .

Tjetër shqetësim i tij janë pikat shtesë në rendin e ditë, që vijnë për miratim herë pas here në Këshill duke mos na lënë kohë ti marrim në shqyrtim.

Znj. Shala thotë se jemi njoftuar për heqjen e pikës 8 nga rendi i ditës, por mesa sheh ajo vazhdon të jetë.

Sqaron këtu **Z. Luli** duke thënë se rendi i ditës do miratohet nga këshilltarët me ndryshimet që u përmendën më lart.

Përsëri **Znj.Shala** shprehet se pas mbledhjes së Kryesisë nuk duhet të ketë Shtesa në rendin e ditës.

Z.Luli përsërit që kjo është tagër e Kryetarit të Bashkisë sipas rregullores. Ai mund të paraqesi Pr/Vendime shtesë në çdo kohë nëse është e nevojshme dhe emergjente.

Ai po ashtu shton se përsa i përket qytetarëve për të ndjekur mbledhjet e Këshillit , ato kanë transparencë të plotë nga transmetimi live, pasi vendet në sallë janë të limituara.

Hidhet në votim rendi i ditës me ndryshime, , ku rezultojnë **28** vota Pro **10** Kundër **0** Abstenim.
Miratohet

Vijohet me pikën 1. të rendit të ditës: *Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2024"*.

Siç është rënë dakord ky pr/akt s'ka nevojë për relativ prandaj kalohet në votimin e kësaj pike, ku rezultojnë **39** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën 2.: *Pr/ Vendim: "Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike"*.

Edhe kjo pikë nuk ka nevojë për relativ prandaj kalohet direkt në votim, , ku rezultojnë **39** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: *Pr/ Vendim: Për një shtesë në VKB nr.76 datë 19.12.2024 „Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës.“ Dhe detajim të fondeve sipas aktit normativ nr.5 datë 19.12.2024 të Ministrisë së Financave"*.

Relaton për këtë pikë **Z.Mema**, drejtor i përgjithshëm i drejtorisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet në pyetje e diskutime. Fjalën e merr **Znj.Bajraktari** e cila thotë se kemi një tranfertë të pakushtëzuar që kaloi në dhjetor, gjithsej 18 milion. Nuk na është sqaruar se ku ka shkuar teprica. Sot flasim për tjetër shifër 45 milion, e cila është pothuajse e barabartë me buxhetin e parashikuar për arsimin nga Bashkia Shkodër. Kaq e prioritet është Merkato Rus me kaq shumë fonde për të? Për më tepër sa janë saktësisht të ardhurat që ky treg do gjenerojë?

Përgjigjet **Z.Mema** duke thënë se momentalisht për arsye të kushteve krejtësisht të degraduara, tregtarët aty i përdorin ambjentet e merkatos vetëm për ato pak dhoma frigoriferike që ka, prandaj duke përmirësuar infrastrukturën dhe kushtet, ne kërkojmë që të shtohet ndjeshëm numri i tregtarëve që do tregtojnë aty.

Z.Gjergj Sokoli, shprehet se merkato Rus është imazh i shëmtuar edhe për turizmin e qytetit, pastaj tregtimi dhe siguria ushqimore duhet të jetë primare.

Përsëri **Znj.Bajraktari**, thotë se nëse duam të flasim për turizmin , atëherë më mirë është të ndërhyhet në një nga lagjet më të vjetra të qytetit, poshtë Kalasë, në Qafë, ku as kanalizime minimale nuk ka.

Znj.Mehmetaj merr fjalën dhe shprehet se kolegja ka plotësisht të drejtë se Shkodra ka shumë problem. Por Merkato Rus ka qënë prej vitesh pjesë e planit strategjik i Bashkisë, ndryshimi i vetëm është se vetëm tani po financohet.

Znj.Shala edhe njëherë thotë se Tregu Rus është projekt i Bashkisë së kaluar dhe jemi plotësisht dakort me ndërhyrjen në të por jemi kundër shumave marramendëse kur Shkodra ka plot prioritete të tjera. Dhe asnjëherë nuk mund të thoni që nuk jemi të ndjeshëm ndaj sigurisë ushqimore. Prandaj kërkojmë më shumë argumentacion pasi në pr.vendimi është shumë i vakët. Në të thuhet se frekuentimi i Tregut Rus është shumë i ulët dhe nuk dihet sa tregtarë tregtojnë aty. Ajo thekson faktin që ky është projekt i fituar nga Bashkia e shkuar.

Sqaron këtu **Z.Mema** duke thënë se pas ndërhyrjes së parë në Tregun Rus, kemi rritje të numrit të tregtarëve aty. Me tej kërkesa për investim që është bërë nga Ministria është për më tepër dhe I gjithë dokumentacioni I nevojshëm për procedurë do bëhet I njohur dhe do kaloi në Ministrinë e linjës.

Znj.Shllaku thotë se si këshilltar jemi shumë të ndjeshëm nga problemet e Shkodrës dhe nuk mund të akuzohemi për të kundërtën. Ne thjesht nuk jemi për shumta marrëmendëse për këtë treg, në një kohë që ka prioritete të tjera aq më tepër që sot po kërkohet përsëri për një shtesë fondesh.

Z.Imeldi Sokoli thotë se sot po prezantohet një treg, pjesë e një Sh.a-je që është kaluar në pronësi të Bashkisë e miratuar në Këshill dhe nga e cila nuk kemi marr asnjëherë asnjë raportim. Ne nuk kemi asnjë informacion se çfarë ndodh me të, si pronë e Bashkisë: Nuk dimë sa lek ka harxhuar kjo sh.a dhe pse nuk është e pasqyruar në buxhet. Së dyti, sot Bashkia Shkodër kishte detyrim të sillte vlerësimet, parashikimet dhe shpenzimet afatmesme në Këshill Bashkiak dhe tregu i Rusit duhet të kalonte në Këshill dhe jo me firmë të kryetarit.

Znj.Nika merr fjalën dhe thotë se po ta kishit lexuar me vëmendje Pr/buxhetin do ta kishit kuptuar që problemet me ngrohjet në shkolla tashmë janë të miratuara me kohë, pa patur nevojë për fonde shtesë. Thjeshtë nuk janë zbatuar Akoma pasi kemi trashëguar një infrastrukturë të degraduar. Pra ekziston fincimi por së pari duhet të vihet dorë në infrastrukturë. Dhe është bërë një punë e mirë në këtë drejtim nga Bashkia Shkodër që duhet përgëzuar.

Z.Mema sqaron se kjo sh.a ka kaluar në Këshill për miratim dhe jo me firmë të Kryetarit. Dhe për më tepër në Buxhet ka edhe informacion për të.

Z.Sokoli shton përsëri se ka para syve Buxhetin e miratur dhe për këtë sh.a nuk ka tabela përkatëse.

Ndërhyn këtu **Znj.Haxhi** dhe konfirmon që tabelat janë të paraqitura në buxhet.

Znj.Shala: Ai buxhet që e votuat....

Z.Luli shprehet se kjo nuk ka të bëjë me rendin e ditës. Për cdo gjë tjetër mund të bëni një kërkesë dhe të merrni përgjigjet e dëshiruara.

Z.Pashuku shprehet lidhur me zhvillimet që po bëhen tek rruga e Velipojës, tek Harku I Bërdicës dhe kërkon të dijë nr.e individëve që përfitojnë nga shpronësimet.

Znj. Haxhi sqaron që përfitues janë 66 individë.

Z.Pashuku përsëri shton se kemi shqetësim nga banorët e Harkut të Bërdicës...

Përsëri **Z.Luli**, ju lutem nuk jemi tek pika e diskutimeve jashtë rendit të ditës.

Z.Bjanku mendon se argumentimi I kostos është I pamjaftueshëm në Pr/vendim. Duhet të ishte më e specifikuar, duhet të ishte më e specifikuar, duhet të kishim një analizë kostoje.

Z.Mema sqaron se cdo preventiv/ kosto I referohet manualit të Ministrisë.

Znj.Leqejza ndërhyr dhe shprehet se për pyetje, diskutime dhe paqartësi kemi komisionet, kemi e-mail etj. ku mund të kërkojmë sqarime më të detajuara. Asaj I duket e kotë të marrim kohë në mbledhjen e Këshillit për këtë.

Znj.Shllaku dhe **Z.Bjanku** kërkojnë respekt dhe nuk është aspak etike që të shprehem me "Diskutimet të kota" për kolegët.

Znj.Shala shprehet se tregu I Rusit, shpronësimet janë shumë të rëndësishme. Ajo kërkon të dijë sim und të vijnë tre gjëra kaq të rëndësishme me një pr/vendim?

Z.Mema përsëri thotë se sot ne po detajojmë tre gjëra në një dhe nuk është e nevojshme të vijmë në Këshill me tre pr/vendime për të sqaruar një shumë të caktuar.

Kalohet tek mendimi I kryetarëve të grupeve, ku **Z.Ndou** dhe **Z. Sokoli** shprehen Pro, kurse **Znj.Shala** nga grupi i BF-së dhe **Znj.Shllaku** nga grupi i PD-së abstenojnë për arsyet e sipërpërmendura.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **26** vota Pro **10** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Znj.Duhani shprehet se ajo nuk ka votuar pasi nuk ju dha fjala.

Z.Luli thote se ju lutem kërkon fjalën më zë, sepse nuk e kam parë doren tuaj.

Edhe **Z.Shkjau** argumenton pse ka abstenuar duke thënë se vlera për shpronësimet I duket e ulët.

Kalohet tek pika 4. e rendit të ditës: *Pr/ Vendim: "Për miratimin në parim të vlerës së bashkëfinancimit dhe listës së përfituesve për realizimin e projektit "Përmirësim i Infrastrukturës, kryesisht në zonat informale" (Rikonstruktion Rruga Roza Lejn dhe Degëzime) "*

Relaton përsëri **Z.Mema** sipas materialit të përgatitur nga administrate.

Fjalën e merr **Z.Gjergj Sokoli** duke përgëzuar dhe vlerësuar kolegët që kanë lobuar për ndërhyrjen në këtë rrugë shume të rëndësishme për komunitetin.

Znj.Bajraktari shprehet se në buxhetin e 2025 u miratua një buxhet prej 20 milionësh për rr.Roa Lejn. Pas vetëm 3 javësh na kërkohet të miratojmë një fond shtesë. Kemi plot rrugë të tjera që kanë nevojë për investim duke marr parasysh edhe numrin e banorëve sic është rasti I Rrugës së Qafës, dhe Rr.Vekshar që janë edhe imazh tek turistët.

Z.Mema sqaron se duhet të vihet re se në pr/vendim nuk bëhet fjalë vetëm për Rr.Roza Lejn por edhe për disa degëzime.

Z.Shkjau shprehet se ne jemi për sa më shumë investime e ndërhyrje në rrugë por duhet patur parasysh edhe Rr.Qafës dhe Rr. Veksharit.

Përsëri **Znj.Mehmetaj** thekson nevojën e domosdoshme për ndërhyrje në rrugën në fjalë. Ajo përgëzon Bashkinë Shkodër që më në fund po investohet dhe po u lehtësohet jeta atyre qytetarëve aq më tepër që në këtë zonë janë edhe tre shkolla. Më duket diskriminuese të themi se ka plot rrugë të tjera që kanë nevojë për ndërhyrje.

Znj. Bajraktari thekson se nuk është aspak qëllimi im diskriminimi i asnjë zone. Në buxhetin e dhjetorit ne ishim dakort që të investohej në këtë rrugë....

Ndërhyn **Z.Luli** dhe thote se si mund të shpreheni se ishit dakort kur ju nuk e votuat buxhetin...

Z.I.Sokoli thotë se në pr/vendim nuk është paraqitur mënyra e pikëzimit, pra nuk kemi një justifikim për këtë.

Znj.Shala shton se jemi shumë dakort për investimin në fjaë, thjesht ne kërkojmë që informacioni të jetë më i detajuar se pr/vendimet na vijnë të mangëta dhe kjo vlen për të gjitha pr/vendimet.

Z.Luli thotë se informacionet e detajuara mund t'i kërkon në mbledhjet e komisioneve.

Përsëri **Znj.Shala** thotë se në mbledhjet e komisioneve vetëm këshilltarët e opozitës janë prezent dhe nuk është faji i tyre që nuk bëhet kourumi.

Z.Anamali në lidhje me Rr.Roza Lejn dhe disa rrugë të tjera, thotë se në komisionin e buxhetit në dhjetor kam kërkuar të dijë më tepërr për pikëzimin dhe pse janë kualifikuar pikërisht këto rrugë dhe jo të tjera. Atë ditë nuk pati asnjë argument dhe asnjë përgjigje për këtë detaj.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen pro Pr/vendimin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **3** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 5. e rendit të ditës. *Pr/ Vendim: "Për miratimin në parim të bashkëfinancimit në zbatim të fondeve të planifikuara për programet e strehimit social për vitin 2025, për realizimin e një kati shtesë në objektin: Banesa sociale me Qira (Ish-Konvikti i Shkollës Veterinare), i përshtatur për strehim social".*

Relaton për këtë pikë **Znj.Mirza Bërdica**, specialiste pranë drejtorisë së përgjithshme të Zhvillimit të Qëndrueshëm ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administata.

Fjalën e merr **Znj.Kopliku**, e cila pyet se si do menaxhohen familjet që janë në katin e parë gjatë kohës që po punohet aty?

Përgjigjet **Znj.Bërdica** duke thënë se punimet aty do zgjasin 5 muaj. Dhe do mendohet për një sistemim për këto familje.Gjithmonë besoj se do kemi konsensusin e tyre.

Përsëri **Znj.Kopliku** shprehet se do doja të justifikonit 13 milion që teprojnë nga 30 milionët e miratuar në buxhetin e këtij viti.

Znj.Shala kërkon të dijë se sa kërkesa kemi sot për njësi të tilla banimi dhe sa është sipërfaqja që do ndërtohet pasi vlera është relativisht e madhe për njësi banimi.

Znj.Bërdica përgjigjet duke thënë se preventive është kryer nga inxhinierët me cmimet e reja të 2024. Ajo shton se kemi 148 kërkesa për njësi banimi, por janë mikes, ku shtatë janë vetëm për banesa me qira dhe të tjerat janë të hapura që mund të aplikojnë edhe tek skema e subvencionit të qirasë.

Z.Anamali në lidhje me banesat që janë tashmë në gjendje, a ka nga Znj.Bërdica shprehur se sipas informacioneve që kemi nga drejtoria e strehimit janë 79 njësi banimi në total dhe prej tyre 76 janë me kontratë.

Z.Bjanku kërkon të dijë sa mund të jetë kostoja e ndërhyrjes për m2?

Sqarimin e detajuar për këtë e jep **Znj.Flora Hila**, inxhinieri dhe përgjegjëse në sektorin e Planifikimit dhe Ndjekjes së Investimeve në Bashkinë Shkodër duke thënë se preventivi është llogaritur me cmimet e vitit 2024 dhe është në formatin online, që mund të ndryshoi nga muaji në muaj.

Z.Gjergj Sokoli ka tre pyetje: A do jenë përfitues personat që trajtohen me bonus qiraje apo të tjerë? Së dyti a ka Bashkia Shkodër banesa për raste emergjente? Dhe së fundmi a është e mundur që zyra e strehimit të jetë e ndarë nga çështjet sociale sin ë Bashkitë e tjera?

Përgjigjet **Znj.Arlinda Kruja**, drejtoreshë e Shërbimit social dhe strehimit duke thënë se patjetër që përfitues do jenë aplikues nga program.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve, të cilët janë të gjithë dakort me pr/aktin.

Kalohet në votimin e këtij pr/akti, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: *Pr/ Vendim: "Për një ndryshim në emërtimin dhe ndryshimin e fushës së përdorimit të pjesshëm në VKB nr.51, datë 14.04.2009 "Për miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër", miratuar me VKM nr.421, datë 02.06.2010, të ndryshuar, sipas lidhjes 1, të pronës me numër rendor 13, sipas formularit për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore".*

Relaton për këtë **Z.Alban Preka**, drejtor në drejtorinë e aseteve në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrate.

Znj.Shala thotë se me VKB nr.37 datë 26.10. 2023 ju si shumicë keni miratuar kalimin e pronësisë për 10 vite me qira për UKSH-në,kati i dytë me detyrimin e sistemimit të Qëndrave Shëndetësore. Sot po vini me një kërkesë për ndryshimin e fushës së përdorimit. Shpresoj që ky objekt të mos ndryshojë destinacion. Ajo shton se kërkon të saktësohet, kush punon sot aty kur nuk ka asnjë leje për ndërhyrje, prej kujt po financohet? Do doja një përgjigje me përgjegjësi ligjore për këtë.

Z.Preka thotë edhe njëherë sa për saktësim, bëhet fjalë për ndryshim të fushës së përdorimit jo për godinën e Adisës por të godinës përballë ish-hotel Sporti që në të ardhmen mund të bëhet me kushte optimale në një qendër shëndetësore me të gjithë parametrat, duke qënë se nga mbledhja e Komisioneve ka dal si problem edhe aksesueshmëria në katet e dyta dhe të treta.

Znj.Shala kërkon të dijë se çfarë do bëhet me ambjentet e Adisës, që janë përdorur deri tani nga qendrat shëndetësore, meqënëse ato po kalojnë në godinën përballë. Për më tepër shton ajo si do hyjnë në 127 m2, 6 qendra shëndetësore me një personel prej 20 vetash? Ajo shprehur se nuk ka informacion se nga drejtoria aty është bërë një kërkesë për zhvendosje, prandaj kërkon të dijë si është marrë ky vendim?

Përsëri **Z.Preka** thotë se në godinën ish-hotel Sporti janë dy njësi me nga 127 m2 dhe gjithçka do shërbejë në të mirë të komunitetit. Aq më tepër që sot nuk po vendosim për këtë.. Ne po mendojmë për një ndërhyrje në infrastrukturë, kjo pjesë e procedurës. Sot kërkohet vetëm ndryshimi i fushës së përdorimit.

Përsëri **Znj.Shala** shprehet se si specialiste e fushës nuk është aspak dakort që Q.shëndetësore të kalojë aty. Gjithsesi ajo kërkon të dijë nga kush po punohet tek Adisa dhe a ka një leje ndërtimi për këtë?

Z.Luli thotë se për pyetjen tuaj mund të depozitoni një kërkesë pasi nuk ka lidhje me rendin e ditës.

Znj.Shala thotë se kërkesa ime ka shumë lidhje sepse po kërkohet të ndërhyhet në Q.shëndetësore që ofrojnë shërbim për një numër të madh banorësh të asaj zone jashtë çdo kushti që duhet të ketë një e tillë. Aq më tepër që sot po flitet për investime në rrugë e tregje, në një kohë që Bashkia është përgjegjëse për godinat e Q.shëndetësore dhe shërbimi mjekësor është thelbësor për qytetarët. Përsëri ajo kërkon të dijë se çfarë po punohet dhe a ka leje punimesh tek Adisa.

Z.Gj.Sokoli shprehet se shqetësimi i koleges është i pranueshëm aq më tepër që znj. Shala është profesioniste e fushës. Ai kërkon të dijë nëse godina ku mendohet të shkojnë Q.shëndetësore I plotësojnë kushtet higjeno-sanitare.

Përsëri përgjigjet **Z.Preka** duke thënë se nuk mund të merret asnjë vendim në lidhje me lëvizjen e qendrave pa u ndryshuar fusha e përdorimit. Ky është hapi i parë, më vonë do vijmë në Këshill për të tjera ndryshime.

Znj.Duhani shprehet se nëse nuk është në kushte të përshtatshme, nuk mund të miratojmë transferimin e Q.shëndetësore në objektin që pretendohet.

Përsëri Z.Luli sqaron se nuk po kërkojmë të miratojmë transferimin e Q.Shëndetësore po ndryshimin e fushës së përdorimit.

Z.I.Sokoli shprehet se ajo godinë që pretendohet të kryhet transferimi nuk ka as dritare, por spirale. Prandaj ju ftoj të merrni manualin e Min.Shëndetësisë për kushtet që duhet të ketë një qendër shëndetësore. Prandaj përfundimisht aty nuk mund të ketë të tilla. Ai pyet nëse ka një kërkesë nga Bashkia për këtë lëvizje apo nga vetë qendra shëndetësore?

Znj.Kruja përgjigjet për këtë duke thënë se nga dëgjuesat publike, shqetësim i vazhdueshëm ka qënë që tek Adisa Q.shëndetësore nr.2 nuk ka kushte dhe ka problem aksesueshmërie. [Dhe me propozim nga vetë drejtoria është diskutuar dhe sugjeruar vetë ish-hotel Sporti. Por sot duam të bëjmë vetëm hapin e parë. Në vijim me specialistë dhe ekspertë të fushës do shihet sa e mundur është dhe a plotësohen kushtet e domosdoshme.

Z.Bjanku shprehet se si banor i Q.shëndetësore në fjalë kjo nuk mund të kalohet me forcën e kartonit, pasi është në kundërshtim me ligjin. Inxhinierët nuk mund të sistemojnë dot 6 Q.Shëndetësore aty, po nuk u plotësohen parametrat që duhen.

Z.Anamali ka një pyetje për Z.Preka që relatoi. A keni ju një relacion vlerësimi nga ekspertë të fushës që kjo godinë të mund të kthehet në Q.shëndetësore?

Përgjigjet Z.Preka duke thënë se nuk kemi një të tillë, por përsërit që nuk kërkohet sot kjo. Thjesht kërkojmë ndryshimin e fushë së përdorimit.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku **Z.Ndou** shprehet se nuk mendon që Bashkia Shkodër mund të marr një vendim të gabuar për këto Q.Shëndetësore, prandaj janë pro këtij pr/akti. **Z.Sokoli** në emër të grupit të PSD kërkon 5 minuta pushim. Kurse Znj.Shala për arsyet që listuam më lart shprehem kundër. Po ashtu edhe Znj.Shllaku shprehet kundër.

Pas pushimit fjalën e merr **Z.Sokoli**, i cili kërkon sqarim nga Zv/Kryetarja e Bashkisë në lidhje me punimet tek Adisa. Ku do shkojnë Q.Shëndetësore deri në përfundimin e punimeve?

Znj.Kruja thekson faktin se Q.Shëndetësore nuk do lëvizin nga ato ambiente deri sa të gjindet një sistemim për to.

Përsëri **Z.Gjergj Sokoli**, kësaj here unë do ti shkoj deri në fund kësaj çështjeje, pasi Q.Shëndetësore është një shërbim i domosdoshëm dhe ju siguroj që vetë unë do të jem zëri i qytetarëve të asaj zone për këtë.

Znj.Gjekaj thotë se duke qënë se Bashkia Shkodër është pronare e Ish-hotel Sportit ajo mund të marr vendimin për ndryshim të fushës së përdorimit. Për kushtet e një Q.shëndetësore duhet të ketë detyrimisht në një moment të dytë dokumentacion të detajuar. Sot na kërkohet vetëm ndryshimi. Nëse në të ardhmen nuk biem dakort me kushtet nuk do ta votojmë. Si procedurë dhe kërkesë është terësisht ligjore.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **24** vota Pro **12** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 7. e rendit të ditës: *Pr/ Vendim: “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2025”.*

Znj.Pode propozon që kjo pikë nuk nevojë për relatin port ë kalohet direkt në votim.

Zv/Kryetarja **Znj.Qyteza** shprehet se me shumë përzemërsi fton këshilltarët të votojnë këtë pr/vendim. Ajo garanton që zbatuar një procedurë krejtësisht transparente dhe ligjore.

Z.Sokoli merr fjalën dhe thotë se vlerëson stafin e Bashkisë për punën e kryer dhe fton kolegët ta miratojnë pr/vendimin.

Të gjithë kryetarët e grupeve shprehin dakordësi për këtë pr/vendim.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: *Pr/ Vendim: “Për miratimin e planit vendor të mbrojtjes së Biodiversitetit”.*

Relaton për këtë pikë **Znj.Shllaku**, drejtoreshë e Mjedisit sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Shala kemi vërejtur se ka shumë mungesa në përditësime, gjithashtu shohim se nuk ka një strategji konkrete. Do doja të dija edhe a do ketë përfshirje të shoqërisë civile për këtë, dhe cilat janë objektivat e tij?

Përgjigjet **Znj.Shllaku** duke sqaruar se plani është një rishikim i planit të mëparshëm. Kurse për matjet, monitorimet dhe azhurnimet Bashkia Shkodër nuk ka kompetencë për to. Të dhënat janë marr nga agjensia e Mjedisit.

Z.I.Sokoli përgëzon drejtorinë që ka ndërmarë këtë iniciativë por në materialin e paraqitur nuk kemi kostot e këtij plani.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen Pro, kurse Znj.Shala dhe Znj.Shllaku janë kundër.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 27 vota Pro 9 Kundër 0 Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e parë shtesë: *Pr/ Vendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”*

Përsëri **Znj.Pode** propozon votimin e pr/vendimit pasi nuk ka nevojë për relativitet. Edhe kryetarët e grupeve janë dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 37 vota Pro 0 Kundër 0 Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pr/vendimin e fundit: *Pr/ Vendim: “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi, të pronave Ish - Reparti Ushtarak Bërdicë, Pasuria nr 10/127 dhe pasurinë në përgjegjësi të DPSHTRR nga prona shtetërore tek Bashkia Shkodër”*

Relaton përsëri **Z.Preka**, drejtor i Aseteve dhe Kadastrës Urbane në Bashkinë Shkodër sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Pashuku merr dhe kërkon të dijë se si do kryhet ky transferim?

Për këtë përgjigjet **Z.Mema**.

Përsëri **Z.Pashuku** pyet nëse kjo qendër do jetë vetëm për tregtarët e shumicës apo edhe të pakicës?

Sqaron **Z.Mema** duke thënë se kjo qendër do të shërbejë si pikë magazinimi për tregtarët.

Për më tepër sqaron për këtë **Zv.kryetari Z.Beka**.

Znj.Kavaja merr fjalën dhe thotë se ajo mendon që nuk duhet të merremi me vogëlsira, në një kohë që kemi të bëjmë me një investim në dobi të tregtarëve në një pikë strategjike.

Z.Behri shprehet se nga informacionet që ai ka , kjo pronë është me probleme në dokumenta. A është e gatshme Bashkia të marrë përsipër një pronë me probleme?

Edhe **Znj.Bajraktari** ka një pyetje në lidhje me xhaminë e Bërdicës. Ajo kërkon të dijë a ka dakordësi mes Bashkisë dhe Myftinisë për zgjerimin e rrugës aty?

Z.Mema sqaron se jemi vetëm në hapin e parë të procesit, në kalimin e pronës në pronësi të Bashkisë nga Min.Mbrojtjes.

Z.Preka thekson faktin se kërkohet vetëm miratimi i kalimit të pronësisë , në vazhdim do flitet për projektin.

Znj.Leqejza pyet Z.Preka se si jurist që jeni a mund të na konfirmoni që ligji 139 i jep të drejtë Këshillit të jetë gardiani i aseteve të Bashkisë sepse po diskutojmë për një pronë që Ministria i kalon Bashkisë në pronësi.

Z.Preka Ne kemi një shkresë të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila thotë që nëse ju keni projekte ambicioze për zhvillim ,ne jemi të gatshëm që një ojesë të pronës t'ua vëmë në dispozicion.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen Pro, kurse Znj.Shala dhe Znj.Shllaku abstenojnë për mungesë dokumentacioni.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **24** vota Pro **1** Kundër **8** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në votimin e Pr/verbalit të mbledhjes së Këshillit të datës 19.12.2024.

Z.Bjanku thotë se për procedurë pr/verbali që na është përcjellë ka mungesa për momentin e votimit të Buxhetit. Nuk është evidentuar saktë ky moment.

Z.Luli sqaron edhe njëherë këtë moment.

Pr/Verbali hidhet në votim , ku rezultojnë **23** vota Pro **9** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Znj.Duhani ngre shqetësimin e saj dhe të qytetarëve në lidhje me korsitë e biçikletave dhe për semaforin tek Posta, duke thënë se po shkaktojnë shumë problem dhe pakënaqësi. Tjetër shqetësim lidhet me rrugën e Trush-Velipojë që ka probleme. Po dëmtohen nga kjo shtëpitë dhe bizneset në atë zonë.

Znj.Pode paraqet një shqetësim të një grupi qytetarësh tek zona e ish-Fermentimit që është jashtë cdo parametri. Duhet të shihet me përparësi shton ajo. Tjetër evidentim lidhet me ndërmarrjen e pastrit, ka pakënaqësi për fimën zbatuese. Duhet tërheqje vëmendjeje.

Znj.Shllaku gjithashtu ngre disa shqetësime: - së pari për korsitë e biçikletave që kanë rënduar trafikun dhe ka shumë ankesa.

- Së dyti, zënia e trotuareve. Duhet të verifikohet situata dhe të merret në konsideratë.
- Rrezikshmëria nga suvatë e pallateve. Duhet ndërhyrë dhe të inspektohet në terren.
- Parkimet e gabuara. Policia Bashkia duhet të ndërhyjë.
- Presioni që po i bëhet administratës së Bashkisë për votat e diasporës është i papranueshëm.
- Edhe për ngritjen e Komisionit artistiko-kulturor, është e turpshme që të merren njëri nga Tirana.

Zv/kryetari Beka shprehet se nuk e kupton pse duhet të ketë të tilla paragjykime nga qytetarët e Shkodrës për stafin e ardhur nga Tirana.

Znj.Shllaku përsëri shprehet se ato nuk janë kundër kontributit të tyre, por jo të punësohen në Bashkinë e Shkodrës.

Edhe Znj.Shala ndan të njëjtin mendim pasi me të gjithë respektin për këto persona , ajo mendon se ato janë thjesht miq të kryetarit të Bashkisë.Për më tepër ajo ngre shqetësimin e saj për mbeturinat tek shkolla Pyjore, ku një biznes aty ka spostuar kazanët e mbeturinave dhe tani po bllokohet krejt trotuari nga mbeturinat.

Z.Beka shprehet se do shohim situatën aty dhe do merren masa.

Z.Shkjau sugjeron se pikën e diskutimeve jashtë rendit të ditës duhet ta bëjnë në fillim të mbledhjes, në respect të problemeve të qytetarëve. Pasi nuk është aspak normale që këshilltarët të largohen nga salla. Po ashtu ai rikthen në vëmendje problematikën e rrugës “Vekshar”. Ai shton se duhet të paraqitet sa më shpejt në Këshill për miratim ndërhyrja për këtë rrugë. E njëjta gjë vlen edhe për implementimin e ndërtimin e një impianti për ujërat e zeza.

Përsëri **Zv/Kryetari Beka** thotë se nuk jam në dijeni të kësaj rruge, por siguron që do ketë një përgjigje për këtë.

Z.Pashuku shprehet se kanë ankesa nga banorët që preken nga ndërhyrja në Harkun e Bërdicës. Prandaj ai sugjeron një dëgjese publike me banorët e zonës.

Z.I.Sokoli thotë se si anëtarë të Këshillit Bashkiak të PD kemi paraqitur një kërkesë për informacion lidhur me shtëpizat për përdorim nga një palë e tretë. Akoma s’kemi asnjë përgjigje. Ai shton se duhet të njihemi /konsultohemi sa më shpejt edhe me planin e mobilitetit, pasi po i vështirësoni jetën qytetarëve të Shkodrës.

Zv/kryetari Beka përsëri shprehet se për kërkesën e depoituar do keni patjetër një përgjigje në mbledhjen e ardhshme. Kurse për sa i përket planit të mobilitetit, mund të themi se janë kryer dëgjesa publike për këtë. Dhe ju siguroj që Plan i mobilitetit është në fazat e fundit dhe është prioritet për Bashkinë Shkodër.

Znj. Bajraktari thotë se me rikonstruksionin e shkollës Ndre Mjeda dhe kalimin e nxënësve në ambientet e shkollës Shejnaze Juka, problem për prindërit është pjesa e pasdites në lidhje me aksesin e tyre aty, për shkak të punimeve që po kryhet në rrugë.

Z.Beka shprehet se shqetësimi qëndron pasi po kryhen disa ndërhyrje njëherësh, por kërkojmë mirëkuptimin e qytetarëve për këtë, pasi çdo gjë po bëhet në të mirë të komunitetit.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

*Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 30.01.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 13 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e rradhës së Këshillit bashkiak.

Sekretar

Sabina DANAJ



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti



KRYETAR

Oltion LULI

